| Titulli i Programit: | **Përgatitja dhe përdorimi i materialeve mësimore** |
|---|---|
| **Titulli i organizatës:** | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| **Tipi i programit:** | Program trajnues themelor |
| **Ofertuesi i programit:** | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| **Adresa:** | Rr. Lorenc Antoni nr. 38. Prishtinë, 10000 |
| **E-mail:** | Lirije.Bytyqi@rks-gov.net |
| **Telefoni:** | 038/212-645 |
| **Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit** | Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion i pavarur, publik, hulumtues, kërkimor shkencor i themeluar nga MASHT-i. Pozita juridike e IPK është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 8/2017, datë 21.07.2017. Funksionet e Institutit Pedagogjik të Kosovës janë: analizat, hulumtimet, trajnimet, krahasimet dhe vlerësimit në fusha të ndryshme të arsimit në Kosovë. |
| **Numri dhe data e aprovimit të programit:** | Nr. 23/24<br>Datë: 26.02.2024 |
| **Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:** | 26.02.2027 |
| **Kohëzgjatja e programit(orë)** | 3 vite |
| **Përfituesit:** | Mësimdhënësit e Arsimit Fillor |
| **Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:** | Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 20-25. |
| **Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:** | Në përfundim të trajnimit secili pjesëmarrës:<br>-Bënë dallimin mes burimeve dhe materialeve mësimore<br>-Reflekton për rëndësinë e materialeve mësimore,<br>-Vlerëson kriteret për përgatitje dhe përdorim të materialeve mësimore,<br>-Përfshinë materialet mësimore në planifikimet mësimore,<br>-Përgatit materiale mësimore,<br>-Përdor materialet mësimore gjatë punës me nxënës. |
| **Përmbajtja:** | Gjatë tri ditëve sa zgjatë trajnimi, temat kryesore që do të shqyrtohen janë:<br>❖ **Burimet dhe materialet mësimore;**<br>Në kuadër të kësaj teme do të shqyrtohen:<br>- Aspektet konceptuale lidhur me burimet dhe materialet mësimore;<br>- Dallimet mes burimeve dhe materialeve mësimore;<br>- Rëndësia e materialeve mësimore; |

| | |
|---|---|
| | - Llojet e materialeve mësimore.<br><br>❖ <u>Planifikimi i materialeve mësimore</u><br>Mësimdhënësit do të informohen dhe përgatiten për:<br>- Rëndësia e përfshirjes së materialeve mësimore në planifikimet e mësimdhënësve<br>- Kriteret për përzgjedhjen e materialeve mësimore,<br>- Planifikimi i materialeve mësimore.<br><br>❖ <u>Përgatitja e materialeve mësimore</u><br>Mësimdhënësve do t'u ofrohen informacione të nevojshme dhe do të aftësohen për:<br>- Përgatitja e materialeve mësimore bazuar në kritere;<br>- Rëndësia e përfshirjes së nxënësve në përgatitjen e materialeve mësimore.<br><br>Përveç pjesëmarrjes në trajnim, mësimdhënësit angazhohen edhe me punë praktike në shkollë. Mësimdhënësit gjatë periudhës sa zgjat trajnimi, përgatisin planifikime për orë mësimore, përgatisin materiale mësimore në shkollë, përfshijnë nxënësit në përgatitjen e materialeve mësimore. Planifikimi dhe realizimi i këtyre aktiviteteve dokumentohet, përgatitet dosja e cila vlerësohet nga trajnerët e programit.<br>Vlerësimi i dosjes së mësimdhënësve është edhe kriter vlerësimi për certifikim. |
| **Metodat e realizimit të programit** | Aktivitetet kryesore në kuadër të programit janë:<br>1. Trajnimi i mësimdhënësve,<br>2. Puna praktike e mësimdhënësve në shkollë,<br>Trajnimi i mësimdhënësve fokusohet në njohuri të përgjithshme për materialet mësimore, planifikimin, përgatitjen dhe përdorimin e tyre gjatë punës me nxënës.<br>Në kuadër të punës praktike në shkollë përgatiten plane për orë mësimore, dokumentohet përgatitja dhe përdorimi i materialeve mësimore të cilat pastaj vlerësohen nga trajnerët e programit. |
| **Certifikimi** | Pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim do të certifikohen për 60 orë pune. Numri i orëve do të fitohet përmes:<br>- Pjesëmarrjes në trajnim (18 orë)<br>- Përgatitjes së planifikimeve mësimore (12 orë),<br>- Përgatitjes së materialeve dhe përdorimit praktik të tyre (20 orë),<br>- Vlerësimit të dosjes me detyrat nga trajnimi (10 orë). |

| | |
|---|---|
| **Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve** | Për realizimin e trajnimit angazhohen dy trajnere:<br>Lirije Bytyqi Beqiri<br>Afërdita Hajdari Hoxha |